



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar”

(komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Adrian Kamenica - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit:

Enerieta Tarelli – Përfaqësuese nga Drejtoria Juridike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Rovena Moçka – Përfaqësuese nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

A jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Miratohet.

Sot kemi një propozim për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar”.

Kemi të ftuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit zotin Adrian Kamenica, sekretar i Përgjithshëm dhe zonjën Roven Moçka, drejtore e programeve të zhvillimit të turizmit, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Relatore kemi zonjën Gjermani.

Data e shqyrtimit në seancë të projektligjit është 13 dhjetor 2018.

Dakord me rendin e ditës? Dakord.

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani - Faleminderit!

Në fakt, ndryshimet që vijnë për ligjin “Për turizmin”, të ndryshuar”, janë të vogla në dukje, por janë goxha të rëndësishme në kuadrin e përpjekjeve që ka bërë qeveria shqiptare për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në përgjithësi.

Konkretisht, ndryshimet konsistojnë në faktin që shtohet një nen në këtë ligj, ku përjashtohen ata sipërmarrës, investitorë, operatorë, menaxhues, që kanë kryer vepra penale apo kanë qenë të dënuar me vendime gjyqësore. Këto individë përjashtohen nga mundësia për të marrë fonde publike dhe kjo më duket gjëja më e rëndësishme.

Pra, këta qytetarë, sipërmarrës, investitorë, operatorë, menaxhues, përjashtohen nëse kanë qenë pjesë e një organizate kriminale, kanë bërë korrupsion, kanë mashtruar apo kanë financuar terrorizmin, vepra të ndryshme penale të dënuara me vendim gjyqësor, duke i përjashtuar nga mundësia për të marrë fonde publike.

Parimisht është një nismë që duhet vlerësuar dhe padyshim gjen mbështetjen edhe nga parlamenti, të cilën besoj se edhe ne do ta votojmë. Ndërsa, kur të vijë puna për ta parë në mënyrë specifike, se si është shkruar, unë kam sugjerime. Kanë ardhur edhe nga Komisioni i Ligjeve sugjerime. Meqenëse ne jemi komision përgjegjës, duhet t’i marrim në konsideratë dhe mund të diskutojmë sërish të pjesa e riformulimit me propozimet tona se si mund të sqarohen apo saktësohen disa terma që mund të lënë vend për abuzime në momentin kur ky ligj do të zbatohet.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Fjala për përfaqësuesit e ministrive për të na shpjeguar diçka më shumë se pse kemi ardhur te kjo iniciativë.

Në fakt, kemi të bëjmë me ligjin “Për turizmin”, ndërkohë që i referohemi vetëm një ligji në kuadrin e luftës pa kompromis ndaj krimin e organizuar. Kjo do të thotë që është për investitorët apo operatorët menaxhues. Po për sektorët e tjerë?

(Diskutime pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Është një konventë ose një raport ndërkombëtar dhe bëhet në të gjitha projektligjet apo ligjet e tjera, por sot ne po diskutojmë këtë të turizmit.

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Urdhëroni!

Adrian Kamenica - Faleminderit!

Është fakt që ky vlen si propozim në kuadër të nismës që është duke ndërmarrë qeveria për luftën ndaj korrupsionit dhe bashkë me këtë ndryshojnë edhe tre ligje të tjera, investimet strategjike për ndihmën shtetërore dhe për investimet e huaja. Pra, është një paketë. Paragrafët janë të gjithë njësoj në të katra ligjet. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ka të bëjë më faktin se përmes ligjit “Për turizmin” investitorët mund të përfitojnë disa incentiva, sidomos fiskale.

Kohët e fundit janë miratuar disa incentiva jashtëzakonisht atraktive dhe të rëndësishme. Kemi parë edhe një interes shumë të madh nga investitorë vendas dhe të huaj për të ndërtuar sipas rregullave që kemi përcaktuar dhe rrjedhimisht për të përfituar edhe këto incentiva fiskale, kështu që mendojmë se është e nevojshme të bëjmë një saktësim ose përjashtim të atyre personave që kanë precedentë penalë për t’u bërë pjesë e përfitimit të këtyre incentivave.

Ndryshimi ligjor konsiston në verifikimin e operatorëve privatë lidhur me çështjet e tyre gjyqësore dhe, po ashtu, përjashtohen nga këto përfitime edhe persona të tjerë që janë në bordet drejtuese të kompanive, të cilat mund të përfitojnë nga këto incentiva fiskale.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, te neni 1, po citoj: “Në nenin 6 paragrafi numërohet me numrin 1 dhe sipas tij shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje: “Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun 6 të këtij ligji çdo investitor, operator, menaxhues, kur ka të dhëna se

është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme””.

Ajo që mua më vret veshin dhe mendoj se nuk është korrekte nga ana ligjore është “çdo investitor, operator, menaxhues, kur ka të dhëna se është ose ka qenë i dënuar”. Kjo është shumë abuzive dhe lë shteg për keqpërdorim. Mendoj se nëse është i dënuar, duhet ndryshuar nëse është i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, se “kur ka të dhëna”, lë shumë vend për interpretime.

Eduard Shalsi – A keni ndonjë koment?

Adrian Kamenica – Janë të njëjtat reflektime edhe të Komisionit të Ligjeve, të dyja që do të prezantohen. Po vendosëm me komisionin e Ligjeve që ta ndërrojmë me “nëse është” dhe të heqin paragrafin “kur ka të dhëna”.

Eglantina Gjermani – Për mua jo “nëse është”, por “kur është”.

Adrian Kamenica – Ne pak më poshtë do të kërkojmë një certifikatë konkrete për këtë dhe ajo do të vërtetojnë nëse është ose ka qenë.

Eduard Shalsi – Për këtë pikë.

Urdhëroni, zoti Leka!

Edmond Leka - Faleminderit!

Sot kemi shumë operatorë në treg që kanë qenë të dënuar, për të gjitha këto vepra që ne lexojmë, kanë qenë të dënuar për korrupsion, mashtrim dhe sot operojnë në treg. Çfarë do të ndodhë me ta?

Eglantina Gjermani - Më falni! Për sqarim, thjesht këta përjashtohen nga dhënia e ndihmës së fondeve publike, jo se do t’u hiqet e drejta e të bërit turizëm, do të jenë menaxhues, anëtarë bordi, por fonde nga shteti nuk mund të marrin. Ky është thelbi i ndryshimit.

Edmond Leka - Më shumë edhe për opinionin publik, meqenëse janë edhe mediet, të sqarohen gjërat, sepse nuk bëhet fjalë për çdo të dënuar, bëri dikush një aksident, të jemi pak më konkretë. Janë të përcaktuar qartë personat që nuk përfitojnë më fonde publike. Është e përcaktuar shkalla e dënimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë e kisha më tepër sqarim për opinionin publik, të mos mendojnë se gjithçka është ...

Eduard Shalsi - Vazhdojmë me pikën e dytë.

Eglantina Gjermani - Në vazhdim po te ky nen kemi disa kategori veprash penale: pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur dhe

organizatë terroriste, germa “b”, korrupsion, germa “c” mashtrim, germa “ç” pastrim parash ose financimi i terrorizmit, vepra me qëllime terroriste, nuk po i lexoj të gjitha, janë nga germa “a” të “ë”-ja.

Nga kolegët e Komisionit të Ligjeve kemi dy sugjerime, për germën “d” dhe germën “n”. Në fakt, germa “d” është vepra me qëllime terroriste, vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, nxitje, ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste.

Kolegët e Komisionit të Ligjeve sugjerojnë: “Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste”.

Ndërsa për germën “ë”: “Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore”, kolegët e Komisionit të Ligjeve sugjerojnë: “Shfrytëzimi i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore”. Meqenëse këto janë disa kategori veprash penale, unë bashkë me këshilltarët e komisionit sugjerojmë që t’i referohemi Kodit Penal dhe të shkruajmë: Veprat penale të listuara nga germa “a” deri në germën “ë” të harmonizohen me emërtimin e veprave penale sipas Kodit Penal, që të kemi të njëjtën terminologji, të njëjtat vepra dhe t’i referohemi atij Kodi, për të qenë njëloj. Këtu themi “punën e fëmijëve”, por duhet të shprehemi ndryshe.

Nëse janë në Kodin Penal, atëherë kuadri ligjor referohet dhe harmonizohet me të njëjtën terminologji, dakord?

Eduard Shalsi - Dakord.

Po, zoti Marto.

Andrea Marto - Unë shikoj se këtu ka një sërë veprash penale, për shembull një falsifikim, nëse një subjekt është dënuar, ka bërë dënimin, është rehabilituar për një falsifikim të thjeshtë, pse duhet t’i mohohet e drejta? Mos biem në shkelje të të drejtave, të Kushtetutës?

Eduard Shalsi- Ka ndonjë koleg tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një koment për këto sugjerime?

Adrian Kamenica - Ne i kemi diskutuar edhe me Komisionin e Ligjeve dhe parimisht jemi dakord me të gjitha sugjerimet edhe për këtë pikë.

Lidhur me falsifikimin, mendimi im personal është se nëse është marrë një vendim gjyqësor i formës së prerë, ai është një akt penal, sidoqoftë, i madh, i vogël, nuk mund ta përcaktojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me pak fjalë, shkallën e ka vendosur gjykata.

Eduard Shalsi - Ta sqarojë edhe një herë zonja Gjermani se për çfarë bëhet fjalë.

Eglantina Gjermani – Qytetarët që mund të kenë kryer vepra të ndryshme penale, kanë kryer dënimin, janë rehabilituar, vazhdojnë biznesin apo sipërmarrjen e tyre private në turizëm apo kudo qoftë, sepse janë qytetarë të lirë. Ne po flasim për të mos u dhënë fonde publike, kryesisht fonde nga Ministria e Mjedisit dhe e Turizmit, apo nga donatorë, fonde publike nga pushteti vendor apo nga institucione të tjera, të cilat mbështesin zhvillimin e turizmit. Duke qenë se këto vepra penale kanë një impakt në jetën e qytetarëve, të paktën ata janë të lirë ta vazhdojnë sipërmarrjen, por ne si shtet, si qeveri, të mos i financojmë përmes fondeve publike, por nuk i pengojmë që të zhvillojnë turizmin. Këtu ka një ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri - Cilët janë elementët që me të vërtetë për shoqërinë janë precedentë? Ky precedent të vihet në një ballafaqim shoqëror, që ti me këtë precedent që ke, nuk je më një figurë që duhet të përfitosh nga fondet publike.

Mashtrimi, ka mashtrim nga një ndryshim dokumenti. Kodi e përfshin këtë në ato vepra penale shumë të rënda? Këtu është e gjithë loja, te falsifikimi. Sa dënohesh për falsifikim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Falsifikimi futet te dënimi i rëndë, që ai të mos i përfitojë këto fonde?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Debati është: do t'i lejojmë personat e dënuar për veprat e cituara penale të fitojnë kontrata apo marrëveshje politike? Qëndrimi ynë është për jo.

Robert Bitri - Të fusim të gjithë të dënuarit.

Eduard Shalsi- Po flasim edhe një herë për kontrata dhe për marrëveshje publike.

Robert Bitri- Nuk është për marrëveshje publike, këto janë përfitimi, subvencione...

Dritan Bici - Unë them se nuk kemi pse të tregohemi shumë të ashpër në miratimin e këtyre ligjeve, sepse u heqim të drejtën njerëzve, por njëkohësisht edhe mundësinë vendit për t'u zhvilluar investime që bllokohen kot. Ne nuk mund të bëjmë ligje të reja, nëse ligji e parashikon se një person ka kryer një vepër penale dhe ka kryer burgun për këtë vepër penale, ai quhet i rehabilituar. Pse ne duhet t'ia heqim këtë mundësi? Njeriu gabon një herë në jetën e tij. Pastaj, për tërë jetën ky tashti u merrka... Një njeri qëllon ta shkelë ligjin dhe të gabojë. Bën edhe burgun. Ne, përkundër atyre lirive që ka njeriu, e marrim nëpër gojë këtë njeri derisa bën burgun, e përdorim edhe si shembull të keq në shoqëri. Ai i ka kryer të gjitha

dhe s'i ka më asnjë borxh shoqërisë, por tërë jetën mbetet me njollë dhe i bllokuar. Unë për vete nuk jam dakord!

Eduard Shalsi – Në rregull!

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Nisur nga komenti që bëri kolegu, unë do të thosha se, nëse shteti ynë do të kishte mundësi të pakufizuara për të mbështetur të gjitha bizneset, qoftë ato që nuk kanë problematika, siç po diskutohet në këtë ligj, qoftë edhe ato që kanë problematika, mund të ishte rasti kur do të vijë një “ndoshta”, do të thosha, që mund të mbështeten edhe ato. Por, kur këto ndihma janë të kufizuara, do të thosha se ajo pjesë që ka ata lloj precedentësh nuk duhet të futet kurrësi në garë me bizneset e ndershme, të cilat nuk kanë problematika të kësaj natyre. Unë jam i bindur se po të futeshin në garë ato lloj biznesesh, ato do të arrinin të fitonin për shkak të formave të tjera që mund të përdorin, kështu që unë nuk e mbështes si opinion.

Rakip Suli – Shkurtimisht, unë jam në një linjë me kolegun Baraj. Nuk është se ata persona po diskriminohen, por edhe mundësia e subvencionimit për këtë fushë është e paktë. Nuk është se ata pengohen në zhvillimin e tyre të biznesit, por kur bëjmë një analizë dhe vëmë re se një biznes ka qenë korrekt, serioz me shtetin, me punëdhënësin, ai duhet të ketë prioritet. Sipas meje, ky projektligj duhet të kalojë. Pastaj është problem tjetër se çfarë ndryshimesh mund të bëhen, si ndryshimi që propozoi relatorja, për shembull. Unë mendoj se duhet të kalojë, sepse ka ardhur momenti kur këto gjëra duhet realizohen.

Eduard Shalsi – Atëherë, përse kemi ardhur te një ligj i tillë? Këtë mund të na e shpjegojë edhe ministria, si dhe kategoritë për veprat penale të cituara. Ne po i heqim mundësinë për të fituar një kontratë apo një marrëveshje publike, jo vetëm subjekteve, investitorit apo operatorit menaxhues, i cili ka një dënim penal si subjekt juridik, por nëpërmjet këtij ligji po ua heqim edhe subjekteve që kanë individë brenda, si përfaqësues të subjekteve.

Pse kemi ardhur te një vendim i tillë? Kemi ardhur sepse, siç e tha edhe përfaqësuesi i ministrisë, është cenuar konkurrenca. Mbase këtu do të duhet një shpjegim pak më i detajuar, se përse vijmë te një amendament i tillë ligjor. E dyta: pse këto kategori të veprave penale?

Pra, një shpjegim të fundit, para se të kalojmë në votim.

Adrian Kamenica – Ligji i turizmit parashikon një sërë incentivash fiskale, të cilat janë shumë të rëndësishme. Një prej tyre, për shembull, është taksa e ndërtimit ose dhjetë vjet heqjeje të tatim-fitimit. Po t'i mbledhim të gjitha këto, krijohet një shumë mjaft e madhe

lekësh. Nga ana tjetër, për të aplikuar dhe për të aplikuar statusin e investitorit strategjik në turizëm, investimi duhet të jetë mbi shumën 50 milionë euro.

Këto shifra i them për të kuptuar, pak a shumë, edhe nivelin e investitorëve që janë duke u qasur tek ne, që janë duke ardhur. Arsyeja kryesore e këtij ndryshimi është për të përjashtuar mbase pastrimin e parave, për të përjashtuar burime jo të ndershme financimi, për të përjashtuar konkurrencën e pandershme etj. Pra, në njëfarë mënyre ne po përpiqemi të filtrojmë të gjithë investitorët, të cilët po paraqiten dhe do të paraqiten në të ardhmen, për të kryer investime të tilla madhore.

Shuma e parave është jashtëzakonisht e madhe. Le të themi se është e rëndësishme për ne, që investimet të kryhen drejt dhe ashtu siç duhet.

Eduard Shalsi – Qartë!

Për çdo gjë i jemi referuar Kodit penal, por do të saktësojmë ndryshimet. Kryesisht, këto referenca janë të lidhura me aktivitetet ekonomike. Pra, të gjitha këto përfitime kanë ndodhur si pasojë e mashtrimeve apo pasaktësive të veprimtarive të tyre ekonomike. Prandaj, ne e përjashtojmë këtë kategori investitorësh dhe fokusohemi te ata që janë më të ndershëm.

Eduard Shalsi – Në rregull!

Kalojmë në votim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni përkatës do të bësh sugjerimin. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili nen është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull!

Fjala për ju, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Ka ndryshime vërtet të rëndësishme, por sërish mund të lënë hapësirë për abuzim. Them se duhen arritur kapacitetet për ta zbatuar dhe monitoruar atë, sepse është goxha i mprehtë dhe i ndjeshëm si ligj, kështu që mund të prekë interesa të mëdha.

Te pika 3: “Për përfitimin e mbështetjes dhe të lehtësive të parashikuara në kreun 6 të këtij ligji, investitori, operatori menaxhues duhet të paraqesë vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.”

Ne sugjerojmë të paraqesë një vërtetim të gjendjes gjyqësore, dhe ky do të jetë si dokument, i cili mund ta provojë këtë gjë, që të mos lërë vend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ashtu quhet. Po.

Eduard Shalsi – Është koncept juridik.

Eglantina Gjermani –Si emërtim. Të paktën të jetë ky dokument i përcaktuar mirë, siç është në ligj, të jetë dokument ezaures në kuptimin që, nëse e paraqet, s'ka nevojë për gjë tjetër. Pra, të mos ua vështirësojmë jetën investitorëve. Nëse e kanë këtë gjë, s'kanë psetë vazhdojnë me të tjera.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Kalojmë te pjesa e votimit në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1, me propozimet e paraqitura.

Kush është dakord me nenin 1?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Atëherë, të nderuar kolegë, shihemi nesër për propozimin e roaming.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë. Dakord!

MBYLLET MBLEDHJA